



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Datë: 31 maj 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 14 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/Nr. ____/2023 të datës 23 maj 2023, shpall:

SHPALLJE E BRENDSHME

Për plotësim me dy (2) pozita për prokurorë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës

I. Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
2. Të ketë vlerësim të mjaftueshëm ose më të lartë të performancës;
3. Vlerësimi "I mjaftueshëm" sipas Rregullores Nr. 12/2015 për Vlerësimin e Performancës të Prokurorëve të Shtetit është pengesë për avancim, deri në vlerësimin e prokurorit sipas Rregullores Nr. 05/2020 për Vlerësimin e Performancës të Prokurorëve të Shtetit;
4. Të mos ketë masa disiplinore në pesë (5) vjetët e fundit, përjashtimisht qortimit dhe vërejtjes jopublike;
5. Të mos ketë filluar hetimi penal;
6. Të ketë reputacion të lartë profesional;
7. Me rastin e avancimit do të merren parasysh pjesëmarrja në trajnime në fushën specifike që ndërlidhet me njohuritë e përgjithshme në procedurë penale, mjetet juridike, praktika juridike e gjykatave vendore dhe ndërkombëtare, përgatitja akademike, punimet shkencore, ligjërimi në akademi apo në nivel universitar, angazhimi i prokurorit në sistemin prokurorial dhe pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare në cilësinë e ekspertit dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese;

8. Prokurori i Shtetit për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, prokurori duhet t'i plotësojë kushtet për të punuar si prokuror në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorive Themelore.
- II. Kandidati që aplikon për avancim duhet të plotësojë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit¹ si dhe ti bashkëngjisin dokumentet si në vijim:
 1. Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;
 2. Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
 3. Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektivist të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.
 - III. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.
 - IV. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 1 qershor 2023 deri më datë 15 qershor 2023.
 - V. Kërkesa duhet të dorëzohet te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e katërt (4) ndërtesa e Prokurorit të Shtetit, rruga "Luan Haradinaj" - Prishtinë, zyra numër 406, të mbyllura në zarf, ose me postë.

¹ Prokurorët të cilët aplikojnë për avancim duhet të plotësojnë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit të cilin mund ta gjejnë në linkun <https://www.prokuroria-rks.org/shpallje/183/332/> duke i bashkëngjitur dokumentet e kërkuara me Rregullore.